



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR  
DREJTORIA JURIDIKE DHE PËRPUTHSHMËRISË SË STANDARTEVE

**Lenda:** Sqarim për DST.

**Drejtuar:** Operatoreve ekonomike,

Autoriteti Rrugor Shqiptar, në bazë të pikës 2 të nenit 42 “Sqarime dhe ndryshime ne dokumentat e tenderit” të ligjit 9643, date 20.11.2006 , si dhe ne rekomandimet e APP-së, njofton operatorët ekonomike të interesuar se ne procedurën e prokurimit me objekt : **“Masa inxhinierike për eliminimin e rreshqitjeve, segmenti rrugor Qafe Mali- Fierze, km 2.5 dhe për pikat e rrezikshme në km 24, km 25+400,25+500”, REF-67454-07-30-2020, bëjme këto sqarime:**

**2.Per kapacitetin ekonomik dhe financiar: pika 2.2.2**

Në pikën 2.2.2 të kapacitetit ekonomik dhe financiar, AK ka kërkuar : Operatori Ekonomik duhet të ketë një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm gjatë tre viteve të fundit 2016, 2017 dhe 2018. Për të vertetuar plotësimin e këtij kushti Operatori Ekonomik duhet të paraqesë kopje të bilanceve të tre viteve të fundit, të paraqitur pranë autoritetit përkatës, të konfirmuara nga ky autoritet , ne të cilat duhet të rezultojë se nuk ka dale me humbje të pakten në dy vite të njëpasnjëshëm si dhe të shoqëruara me akt ekspertizën e kryer nga Eksperti kontabel i autorizuar.

**Sqarojme se ;**

Në lidhje me kërkesën, për Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, sqarojme se, operatorët duhet të paraqitët Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, **vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se:** *“Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:*



- i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh;
- ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh;
- iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".

### **Njesia e Prokurimit**

